



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivered	18-12-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTICKA	7524/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1424/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrta i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1424/2023 të datës 20.11.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1424/2023 të datës 20.11.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Komunës së Pejës.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar sipas Kontratës punës për kohë të pacaktuar me nr.02-112-91653/1 të datës 05.08.2015 në pozitën e punës "Vozitës-Mirëmbajtës" në Komunën e Pejës, ankuesi me datë 20.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7027/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër vendimmarrjes përmes e-mailit të datës 14.11.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me ndryshimin e gradës dhe koeficientit nga R12 Koeficienti 5, në Gj50 koeficienti 3.8.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7027/2023 të datës 20.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) i datës 20.11.2023; Kontratë Pune për kohë të pacaktuar e [redacted] me nr.02-112-91653/1 i datës 05.08.2015; Lista e pagave e muajit Shkurt-Prill 2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi [redacted] sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës ankuesi është i punësuar sipas Kontratës punës për kohë të pacaktuar me nr.02-112-91653/1 të datës 05.08.2015 në pozitën e punës "Vozitës-Mirëmbajtës" në Komunën e Pejës.

Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit N.08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 5 paragrafin 5 ku është përcaktuar se; 1. Kategoritë e zyrtarëve publikë janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit...5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në pozitën e ankuesit "Vozitës-Mirëmbajtës" në Komunën e Pejës. Kolegji i Këshillit konstatoi se në rastin konkret pozita "Vozitës-Mirëmbajtës" është e kategorizuar si nëpunës teknik dhe mbështetës.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil.

Andaj duke pas parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1424/2023 të datës 20.11.2023. Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Komunës së Pejës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 77 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësen/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës. Si dhe me Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Ndërsa me nenin 79 paragrafi 1 përcakton se: Çdo i punësuar i cili


nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente .

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1424/2023

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Pejës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

